

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rikthehet Panairi i Produkteve Artizanale në Green Coast/ "DUART", një mbrëmje kushtuar artit dhe mje shtërisë
ADRESA	https://scantv.al/lajme/shqiperia/rikthehet-panairi-i-produkteve-artizanale-ne-green-coast-duart-n-i33277
BURIMI	scantv.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 16:27:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	4 shtator 2026, 09:23:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7e8694e6fa92ae7c6b7077cbe3f709f1eb7e7219a985ef86ee240271dfb36134
TEKSTI	8c5778445b56dc88b7099e57e428dd28b814c276810c5a895ccafe7f9c7d4f48
PAMJA	36fedc60e8fe483700908b8e1260f3be0c7b31b20b307ec2a66bb4aa0925b542

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	80d26b149ddcab1754d4992a7abd951602741d686271a2e4677cc779e7e943ef
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	af509d61787472ec8e41e2e6baaa0db3fd07d4af4f7a54c9293cb47ba3acab88
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/80d26b149ddcab1754d4992a7abd951602741d686271a2e4677cc779e7e943ef

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

[Karriera](#) [Kontakt](#)
[English](#)

- [Lajme](#)
- [Scan Intel](#)
- [Analiza](#)
- [Dossier](#)
- [Scan Life](#)
- [Emisionet](#)

[English](#)

Created and monetized by  **mediadesk**

 [Live TV](#)

Tregjet

S&P 500
7718,6
0,38%
Nasdaq
26506,99
0,29%
10-Yr Bond
4,78
0,46%
FTSE 100
10831,09
0%
Crude Oil
91,48
0,2%
Gold
4476,6
1,41%
EUR/USD
1,16
0%
<
>

[Shqipëria](#) Postuar më 4 Shtator 2026, 11:23

Rikthehet Panairi i Produkteve Artizanale në Green Coast/ “DUART”, një mbrëmje kushtuar artit dhe mjeshtërisë

Nga Ledina Elezi

- 
- 
- 

 Rikthehet Panairi i Produkteve Artizanale në Green Coast/

Panairi i Produkteve Artizanale është rikthyer për të katërtin vit radhazi në Green Coast, këtë herë nën konceptin “DUART”, që vendos në qendër punën e dorës, materialet dhe procesin krijues pas çdo punimi artizanal.

Artizanë nga fusha të ndryshme sollën në shëtitorën buzë detit punime në qeramikë, dru dhe qelq, bizhuteri, skulptura, qilima dhe makrame, çanta të punuara me dorë, si edhe qirinj, sapunë, parfume dhe shumë krijime të tjera.

Artizanë: “Them që këto panairë janë motori që na bëjnë neve të vazhdojmë dhe të jemi gjithmonë në lëvizje për të qenë gjithmonë në krijimtari të vazhdueshme, sepse sa më shumë panairë të tilla të zhvillohen, dhe ne jemi më pranë njerëzve, dhe punimet tona janë më të prekshme dhe ne na bëjnë gjithnjë më shumë, që të krijojmë gjëra të reja për të qenë gjithmonë më pranë dashamirësve tanë.”

Artizanë: “Kanë interes, sepse ka edhe shumë të huaj këtu dhe të huajt kanë gjithmonë interes më shumë për punët artizanale që bëhen me dorë, handmade.”

Artizanë: “Kënaqësia më e madhe është kur sheh që njerëzit pëlqejnë gjërat që ti bën.”

Këtë vit, eksperiencia u pasurua edhe me dy masterclass-a të dedikuara krijimit të parfumeve dhe qirinjve, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të njiheshin nga afër me procesin e krijimit, të eksperimentonin me aroma dhe materiale të ndryshme dhe të realizonin vetë produktin e tyre.

Pjesëmarrës në masterclass: “Nuk kisha bërë asnjëherë punim me qiri, kështu që u futa te pjesa e masterclass-it dhe ishte shumë eksperiencë e bukur. Ishte shumë qetësuese dhe shumë kreative.”

Pjesëmarrës në masterclass: “Ishte një eksperiencë e re të mësosh diçka ndryshe për qirinjtë, mënyra e dekorimit, se si shkrihen, procesi, ishte diçka shumë e veçantë.”

Panairi tërhoqi vizitorë vendas dhe të huaj, të cilët përgjatë mbrëmjes mundën të takonin artizanët, të zbulonin teknika të ndryshme të punës së dorës dhe të bëheshin pjesë aktive e eksperiencave krijuese.

Pushues: “Më pëlqen shumë, janë të gjitha handmade këtu dhe janë të punuara me dorë të lirë. Mbledhin më shumë njerëz, janë gjëra të bukura, më pëlqen shumë.”

Pushues: “Është shumë bukur fakti që njerëzit menaxhojnë të bëjnë diçka të tillë për njerëzit që vijnë, sidomos për turistët dhe të tregojnë bukurinë e Shqipërisë, është diçka shumë e veçantë. Është hera e parë që vijmë këtu dhe është mrekulli.”

Përmes aktiviteteve që sjellin së bashku artin, kulturën dhe krijimtarinë, Green Coast vijon të pasurojë kalendarin veror me evente që i japin një dimension të veçantë eksperiencës buzë detit dhe krijojnë momente takimi mes njerëzve, artist dhe traditës shqiptare.



Bota 4 Shtator Lidion Kulla

Volkswagen do të shkurtojë 100,000 vende pune/ Ristrukturimi më i madh i ndodhur ndonjëherë në industrinë e automjeteve

Kompania Volkswagen është gati të pushojë nga puna 1 në 7 prej punëtorëve të saj. Gjigandi gjerman i makinave njoftoi se drejtuesit e kompanisë dhe.....



Shqipëria 4 Shtator Elisabeta Dosku

Në 19 vite, 285 mijë qytetarë legalizuan shtëpitë/ Refuzohen 6 mijë aplikime. Procesi përfundon në 2028-ën

Pavarësisht se ka vite që ka nisur, procesi i legalizimit të ndërtimeve informale konsiderohet si një proces kompleks dhe afatgjatë, i kushtëzuar nga numri i.....



Shqipëria 4 Shtator Ernilda Luzi

Aeroporti i Tiranës kryeson rajonin/ Rreth 6 milionë pasagjerë në gjashtë muaj

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës vijon të shënojë rezultate të larta në trafikun ajror, duke kryesuar aeroportet e rajonit për numrin e pasagjerëve gjatë.....



Europa 4 Shtator Edel Strazimiri

Londra nis epokën e robotaksive - Makinat autonome janë të disponueshme, por me shofer sigurie në bord

Londinezët mund të përdorin për herë të parë taksi autonome me qira, pasi automjetet e kompanisë britanike të teknologjisë Wayve janë shtuar në aplikacionin.....



Bota 4 Shtator Edel Strazimiri

Uber shkurton mbi 3 mijë vende pune në mbarë botën - Kompania orienton kursimet drejt robotaksive dhe inovacionit

Uber ka njoftuar shkurtimin e rreth 3,300 vendeve të punës, ose afërsisht 10% të fuqisë së saj punëtore globale, në reduktimin më të madh të stafit që nga.....



Bota 4 Shtator Edel Strazimiri

SHBA, tarifa deri në 100% për dronët kinezë - Masa synon të frenojë varësinë nga Kina dhe të forcojë prodhimin vendas

Tarifat e reja amerikane për dronët dhe disa prej komponentëve të tyre kanë hyrë në fuqi, në një përpjekje të Uashingtonit për të kufizuar varësinë nga.....



Europa 4 Shtator Edel Strazimiri

BE “godet” Airbnb, ja çfarë ndryshon! - Brukseli synon të lehtësojë krizën e strehimit në zonat më problematike

Komisioni Evropian pritet të propozojë rregulla të reja për strehimin, të cilat do t’u japin autoriteteve kombëtare dhe lokale më shumë hapësirë për të.....



Bota 4 Shtator Edel Strazimiri

Abuzime me rrjetet informale të transferimit të parave - Teknologjia po u jep grupeve kriminale mënyra të reja për të fshehur fondet

Keqpërdorimi kriminal i rrjeteve informale të transferimit të parave po shndërrohet në një problem global dhe është në rritje, paralajmëron Task Forca e.....

Live TV

 Të fundit

Analiza 5 Shtator scan

[**Francis Fukuyama: Inteligjenca artificiale dhe ana e keqe për demokracinë**](#)

Francis Fukuyama nuk ka frikë ta pranojë kur ka ndryshuar mendje. Teoricieni politik dhe profesori i Universitetit Stanford ka ndryshuar herë pas here gjatë.....

Shqipëria 5 Shtator Scan TV

[**Rama nga Cernobbio: Integrimi gradual, rruga e Shqipërisë drejt BE-së**](#)

Kryeministri Edi Rama, i pranishëm në Forumin e Cernobbios në Itali, ka folur për perspektivën europiane të Shqipërisë dhe mënyrën se si vendi mund të.....

Europa 5 Shtator Scan TV

[**A po merr fund recesioni ekonomik gjerman? Ekonomia e Gjermanisë shënon shifrat më të mira në vite**](#)

Ekonomia gjermane po tregon shenjat e para të një rimëkëmbjeje pas një periudhe të gjatë stanjacioni. Ekonomia më e madhe e Evropës po shkon drejt rritjes.....

Europa 5 Shtator Scan TV

[**Karburantet çmime rekord, pavarësisht naftës bruto/ Në Europë kostot ndikohen nga kapacitetet e rafinimit**](#)

Perspektiva e paqes midis Iranit dhe SHBA-së i ka çuar çmimet e naftës ndjeshëm lart e poshtë në muajt e fundit. Nafta e papërpunuar Brent, standardi.....

[Të gjitha lajmet](#)

Më të vizituarat



Analiza 5 Shtator scan

[**Francis Fukuyama: Inteligjenca artificiale dhe ana e keqe për demokracinë**](#)

Francis Fukuyama nuk ka frikë ta pranojë kur ka ndryshuar mendje. Teoricieni politik dhe profesori i Universitetit Stanford ka ndryshuar herë pas here gjatë.....



Shqipëria 5 Shtator Scan TV

[**Rama nga Cernobbio: Integrimi gradual, rruga e Shqipërisë drejt BE-së**](#)

Kryeministri Edi Rama, i pranishëm në Forumin e Cernobbios në Itali, ka folur për perspektivën europiane të Shqipërisë dhe mënyrën se si vendi mund të.....



Europa 5 Shtator Scan TV

[**A po merr fund recesioni ekonomik gjerman? Ekonomia e Gjermanisë shënon shifrat më të mira në vite**](#)

Ekonomia gjermane po tregon shenjat e para të një rimëkëmbjeje pas një periudhe të gjatë stanjacioni. Ekonomia më e madhe e Evropës po shkon drejt rritjes.....



Europa 5 Shtator Scan TV

[**Karburantet çmime rekord, pavarësisht naftës bruto/ Në Europë kostot ndikohen nga kapacitetet e rafinimit**](#)

Perspektiva e paqes midis Iranit dhe SHBA-së i ka çuar çmimet e naftës ndjeshëm lart e poshtë në muajt e fundit. Nafta e papërpunuar Brent, standardi.....



[TikTok sjell komente me zë/ Përdoruesit do të mund të reagojnë me audio dhe të ndajnë më shumë foto](#)

Seksioni i komenteve në TikTok do të bëhet shumë më kaotik. Platforma po ofron një sërë mënyrash të reja për të bashkëvepruar nën video, duke përfshirë.....

** Video**



Video 14:02 - 5 Shtator 2026

[Edicioni i Lajmeve me Ada Hazizollin, ora 15:00, datë 5 Shtator 2026](#)



Video 18:06 - 4 Shtator 2026

[Edicioni i Lajmeve me Zhuljeta Kokën, ora 19:00, datë 4 Shtator 2026](#)



Video 16:04 - 4 Shtator 2026

[Edicioni i Lajmeve me Ada Hazizollin, ora 15:00, datë 4 Shtator 2026](#)



Video 12:12 - 4 Shtator 2026

[Volkswagen do të shkurtojë 100,000 vende pune - Ristrukturimi më i madh i ndodhur ndonjëherë...](#)



Video 11:11 - 4 Shtator 2026

[Edicioni Informativ me Ernilda Luzin, ora 12:00- 04.09.2026](#)



Video 08:08 - 4 Shtator 2026

[Edicioni i Lajmeve me Ervin Postolin, ora 09:00, datë 04 Shtator 2026](#)



Video 17:05 - 3 Shtator 2026

[Edicioni i Lajmeve me Zhuljeta Kokën, ora 19:00, datë 3 Shtator 2026](#)



Video 16:04 - 3 Shtator 2026

[Edicioni i Lajmeve me Ada Hazizollin, ora 15:00, datë 3 Shtator 2026](#)



- [Lajme](#)
- [Scan Intel](#)
- [Analiza](#)
- [Dossier](#)
- [Scan Life](#)
- [Emisionet](#)

Scan është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

NIPT: K12312001A

Created and monetized by  mediadesk

- [Kontakt](#)
- [Të drejtat e përdorimit](#)
- [Cookies](#)

Regjistroni emailin tuën në New **ME SHTO**